Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VII
Sesioni vjeshtor
Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit
Mbledhja nr. 30
Prishtinë, më 15.12.2020, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla e N-506

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Shkëmb Manaj, Abelard Tahiri, Doruntinë Maloku-Kastrati, Alban Hyseni, Dimal Basha, Visar Hoti, Evgjeni Thaçi- Dragusha dhe Donika Kadaj- Bujupi.

Munguan: Artan Abrashi dhe Ljubinko Karaxhiq.

Mbledhjen e kryesoi: Shkëmb Manaj, kryetar i komisionit.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Selim Selimi, Ardian Bajraktari dhe Saranda Salihu, MD; Fatmir Rexhepi dhe Shkëlzen Maliqi, KGJK; Shaip Havolli dhe Bedri Mecini, AKK; Valdete Daka dhe Besnik Buzhala, KQZ; Anita Kalanderi dhe Flutura Berbati-Zena, ANJF; Shkëlzen Bajraktari dhe Arben Ibrahimaj, AKKVP; Enver Zejnullahu dhe Faton Fetoshi, AD; Lavdim Krasniqi, KPK; Drenusha Syla, GP-LDK; Agon Dreshaj, asistent; Venera Aqifi, GIZ; Burim Etemaj, Kuvendi dhe Erdonitë Hebibi, Ekonomia Online;

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Fatbardha Boletini dhe Mirlinda Kolgeci.

Rendi i ditës:

1. Diskutim i përbashkët me institucionet përgjegjëse të sektorit të Drejtësisë, lidhur me adresimin e rekomandimeve të dala nga raporti i vendit për vitin 2020;
2. Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të institucioneve/agjencive të cilat bien në fushëveprim të Komisionit.

1. **Diskutim i përbashkët me institucionet përgjegjëse të sektorit të Drejtësisë, lidhur me adresimin e rekomandimeve të dala nga raporti i vendit për vitin 2020**

Kryetari, tha se tashmë kemi marrë Raportin për Vendin për vitin 2020, raport në të cilin janë evidentuar të arriturat dhe sfidat për institucionet tona, duke përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës. Bazuar në këtë raport, i cili njëherazi paraqet një udhërrëfyes për adresimin e sfidave nga institucionet e vendit, shihet se në disa fusha është bërë përparim, e në disa të tjera kërkohet ndërmarrje e veprimeve konkrete, me qëllim të përmbushjes së sfidave të identifikuara sidomos në fushën e sundimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit dhe të adresimit të procesit të reformës zgjedhore. Po ashtu, tha se në këtë drejtim, në kuadër të të gjeturave për Kuvendin, raporti nënvizon se: "Mbikëqyrja parlamentare e ekzekutivit si dhe institucioneve të tjera mbetet në përgjithësi e dobët, dhe instrumentet ekzistuese parlamentare për mbikëqyrjen e ekzekutivit nuk janë shfrytëzuar. Kuvendi duhet të forcojë punën e komisioneve parlamentare dhe të krijojë mekanizma përcjellës për të mbikëqyrur ekzekutivin si dhe institucionet e tjera. Prandaj, me qëllim të përmbushjes së obligimeve që kanë dalë nga ky dokument, ne si Kuvend i Kosovës pas identifikimit të të gjeturave për të gjithë sektorët më 3.11.2020, kemi mbajtur një takim të përbashkët në mes të kryetarëve të komisioneve dhe kryetares së Kuvendit, znj. Vjosa Osmani, në të cilin takim kemi marr obligim që secili Komision në kuadër të fushëveprimtarisë së vetë të jetë më aktiv në mbikëqyrjen e përmbushjes së obligimeve të dala nga ky raport, nga ana e institucioneve përgjegjëse dhe në këtë formë të përforcojmë edhe më shumë rolin tonë. Sektori i sundimit të rendit dhe ligjit është njëri ndër sektorët më të rëndësishëm, jo vetëm në procesin e integrimit evropian, por edhe në funksionimin e shtetit të së drejtës. Raporti i progresit ka evidentuar ngecje në këtë sektor, por ka vlerësuar edhe të arritura, prandaj, vetëm me punë dhe angazhim të përbashkët dhe duke përmbushur kërkesat të cilat kemi në procesin e integrimit do të mundemi që të avancojmë në rrugën tonë evropiane dhe në të njëjtën kohë në ofrimin e drejtësisë dhe sigurisë për qytetarët tanë. Më tej, tha se ky takim është mundësi e mire që bashkërisht të diskutojmë dhe të shohim se cilat do të jenë modalitet më të përshtatshme për adresimin e tyre.

Ndërkohë, tha se duke u bazuar në Raportin për vendin për vitin 2020 për Ministrinë e Drejtësisë ndër të tjera janë evidentuar këto të gjetura: 1.Të finalizohet puna për Rishikimin Funksional të Sektorit të Sundimit të Ligjit dhe të vendoset një strategji gjithëpërfshirëse sektoriale, që synon forcimin e pavarësisë, paanësisë, integritetit, llogaridhënies, si dhe kapacitetit të përgjithshëm të gjyqësorit dhe prokurorisë, me fokus specifik në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar; 2.Të miratohet Kodit i rishikuar i Procedurës Penale, përfshirë dispozitat për pezullimin e zyrtarëve publikë nën aktakuzë për vepra të lidhura me korrupsionin; 3. Të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat e Tjera Sendore, për t'iu dhënë trajtim kombëtar shtetasve të BE-së që blejnë pasuri të patundshme në Kosovë, në përputhje me MSA-në.

Sa i përket pikës së tretë, që ndërlidhet me plotësim- ndryshimin e ligjeve, kryetari i njoftoi se tashmë si Kuvend e kanë në procedurë Projekt-kodin Civil të Republikës së Kosovës nr.07/L-019

dhe Projektligjin nr. 07/L-021 për të Drejtat Pronësore të shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës. Këto dy drafte janë shqyrtuar në parim në Komision dhe janë në pritje për votim në lexim të parë në Kuvend.

Selim Selimi, tha se Ministra e Drejtësisë përkundër sfidave si pasojë e pandemisë COVID-19, bazuar në të gjeturat e Raportit për vitin 2020, është duke vazhduar punën në hartimin e reformës zgjedhore. Ministria e Drejtësisë i ka kushtuar kujdes të veçantë sfidave të dala nga Agjenda Evropiane, duke punuar vazhdimisht në avancimin e legjislacionit penal, legjislacionin kundër korrupsionit, kodifikimin e legjislacionit të fushës civile.
Selimi përmendi nismat të cilat janë ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë, të rëndësishme jo vetëm shkaku i rekomandimeve, por për gjithë sistemin e drejtësisë, përfshirë, Procesi i Rishikimit funksional i Sektorit të Sundimit të Ligjit, Strategjia për Sektorin e Sundimit të Ligjit, Projekt-Kodit të Procedurës Penale, Projekt- Kodi Civil i Republikës së Kosovës. "Procesi i Rishikimit funksional i Sektorit të Sundimit të Ligjit - është afër finalizimit, proces ky që pritet të reformojë sektorin e Sundimit të Ligjit, duke filluar nga viti 2021. Aktualisht jemi në konsultime shtesë me aktorët kyç të sistemit të drejtësisë. Strategjia për Sektorin e Sundimit të Ligjit, si pjesë e Rishikimit Funksional të Sektorit është finalizuar dhe do të procedohet fillimisht për konsultime, dhe pastaj për miratim në Qeveri, për çka Ministria e Drejtësisë është duke mbajtur takime intensive me institucionet e pavarura, me qëllim të finalizimit të suksesshëm të këtij procesi", tha Selimi.

Selimi, foli edhe për Legjislacionin Penal dhe Civil, ku potencoi ndryshimet që janë bërë në Projekt- Kodin Procedurës Penale dhe Projekt- Kodin Civil. "Projekt Kodit i Procedurës Penale, është finalizuar, ku ndër çështjet kryesore të plotësuara dhe ndryshuara në draft Kodin e Procedurës Penale vlen të ceket se janë shtuar dispozita të reja lidhur me Pezullimin e Zyrtarëve të Lartë Publikë, për veprat penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe korrupsionit, për çka kemi marrë edhe opinion nga Komisioni i Venecias". Selimi shtoi se mbetet i përkushtuar për të bashkëpunuar dhe për të dhënë sqarime shtesë, lidhur me çështjet qe janë shtruar për diskutim dhe bëri thirrje që të miratohet Projekt- Kodi Civil, i cili vlerësohet si akti më i rëndësishëm pas Kushtetutës si dhe Projektligji për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës, që ka për qëllim kryesor rregullimin e fitimit të së drejtës pronësore nga shtetasit e huaj.

Shkëlzen Maliqi- KGJK, tha se të gjeturat nga plani progresit ndër vite kanë qenë në planin e punës të KGJK-së dhe janë identifikuar si nevoja në sistemin gjyqësor. Janë 362 gjyqtarë dhe 1612 staf mbështetës. Janë rekrutuar 37 gjyqtarë në vitin 2019 dhe janë në proces të dekretimit edhe 27 gjyqtarë të tjerë. Ka ngecje të numrit të rritjeve të bashkëpunëtorëve profesionalë. Po ashtu, tha se KGJK-ja ka formuar edhe një grup të punës për rishikimin e stafit të administratës, ku qëllimi është që të zvogëlohet stafi teknik dhe të rritet stafi profesional. Për sistemin për menaxhimin e lëndëve dhe sistemin për evidencën penale është bërë një punë mjaft e mirë. Sistemi i SMIL-it është mbështetur nga Qeveria norvegjeze ku janë në një fazë të konsolidimit të këtij sistemi. Më tej foli edhe për sistemin e shpërndarjes automatike të lëndëve te gjyqtarët, duke premtuar se ky sistem pritet të aplikohet edhe në Gjykatën Supreme dhe atë të Apelit. Sa i përket sistemit të evidencës penale, Maliqi tha se ai është në fazën e fundit.

Lavdim Krasniqi-KPK, tha se duke u bazuar në të gjeturat e Raportit për vendin janë identifikuar sfidat e këtij institucioni. Numri i prokurorëve të aprovuar në sistem është 201, kurse staf administrativ janë rreth 701, të cilët janë pjesë e sistemit prokurorial. Lidhur me sistemin

elektronik të lëndëve është një projekt i përbashkët me KGJK-në dhe aktualisht kanë përfunduar me sistemin e shpërndarjes automatike së lëndëve tek prokurorët.
Sa i përket çështjes së konfiskimit dhe sekuestrimit, tha se të gjitha të gjeturat janë duke u përfshirë në planin e punës për vitin 2021. Po ashtu, sa i përket rasteve të veçuara për nivelin e lartë të korrupsionit, tha se aktualisht janë të përfshira rreth 69 raste dhe kjo data- bazë koordinohet në mënyrë proaktive nga prokurori i Prokurorisë Speciale dhe të gjitha këto raste koordinohen nga Prokuroria Speciale, së bashku me Gjykatat, të cilat punojnë me rastet e gjetura. Ndërsa, rritja e kapaciteteve përfshinë planet e trajnimit për të ardhmen dhe bëri me dije se është rritur numri i prokurorëve, duke kërkuar mbështetje që të ketë rritje më të madhe në të ardhmen dhe po ashtu, rritje edhe të stafit mbështetës.

Shaip Havolli, tha se me Ligjin për Parandalim të Konfliktit të Interesit, tashmë trajtohen të gjithë zyrtarët publikë, pra janë diku 83 mijë zyrtarë, që trajtohen nga ky ligj. Po ashtu, foli edhe për themelimin e Divizionit për mbrojtjen e sinjalizuesve, ku fillimisht ka pasur probleme në zbatim të këtij ligji, por më pas është hartuar rregullorja, se cili është roli i zyrtarëve përgjegjës nëpër institucione. Është angazhuar një ekspert dhe është hartuar manuali për trajtimin e rasteve për sinjalizim; vitin e kaluar një ekspert ndërkombëtarë ka trajnuar stafin e AKK-së për çështjet e hartimit të rregullores. Në lidhje me kallëzimet penale dhe vendimet përfundimtare, tha se jemi njoftuar nga prokuroritë dhe gjykatat kompetente se në vitin 2019 janë proceduar 90 aktakuza, ndërkaq për kallëzimet penale ndër vite që kanë qenë në procedurë, gjatë vitit 2019 janë nxjerr: 84 aktgjykime dënuese, 14 aktgjykime lirimi, 19 aktgjykime refuzuese dhe 2 aktvendime janë hedhur poshtë.

Valdete Daka, tha se në Raportin e vendit, ky institucion ka marrë nota pozitive. KQZ-ja është duke i trajtuar me kujdes rekomandimet e Misionit Vëzhgues të Bashkimit Evropian, të cilët kanë qenë të pranishëm në Kosovë gjatë mbajtjes së zgjedhjeve në vitin 2019, që kanë bëjnë me reformën zgjedhore. Në këto rekomandime janë përfshirë: mbikëqyrja e financimit të subjekteve politike, përfaqësimi i grave në strukturat partiake, mangësitë e votimit jashtë Kosovës dhe pasaktësinë në listën e votuesve. Kanë hartuar draft- planin për rekomandimet e misionit vëzhgues, që ka të bëjë me përditësimin e listës së votuesve, duke krahasuar listën e Departamentit të pensioneve, ku kanë identifikuar 23 mijë persona me të drejtë vote, të cilët tani më nuk janë në mesin e të gjallëve.
Në fund znj. Daka, vlerësoi se është koha që KQZ-ja të ketë Kod Zgjedhor.

Anita Kalanderi-ANJF, tha se niveli i sigurimit të ndihmës juridike në praktikë nuk është adekuat për shkak të legjislacionit kundërthënës, duke pohuar se janë pjesë e grupit të sundimit të ligjit dhe një ndër pikat është edhe hartimi i Ligjit për ndihmë juridike falas, në mënyrë që ndihma juridike falas të ofrohet përmes një organi dhe një buxheti të vetëm koherent në rastet penale, civile, administrative dhe kundërvajtës. Po ashtu, tha se Agjencia për Ndihmë Juridike Falas ka të hartuar një strategji të komunikimit për vitin 2020.

Shkëlzen Bajraktari-AKKVP, tha se si sfidat, që paraqiten në Raportin e progresit, më shumë kanë të bëjnë me plotësimin dhe ndryshimin e Projektligjit për AKKVP-në, i cili tashmë ndodhet në Komisionin për Legjislacion.
Enver Zejnullahu- AD, tha se Akademia e Drejtësisë ka miratuar planin trajnues- kornizë për dy vitet e ardhshme, ku të gjitha temat, që janë cilësuar si mangësi në Raport të progresit, janë

paraparë në planin trajnues. Po ashtu, tha se Ligji për Akademinë e Drejtësisë është shumë i mangët.

Abelard Tahiri, tha se para dy viteve kemi punuar strategjinë për të gjeturat e Raportit të progresit dhe pyeti se kur mund të jetë fundi i implementimit të kësaj strategjie? Një nga të gjeturat në Raport të progresit është se nuk është vazhduar me agjendën "Drejtësia 20 20" dhe a do të vazhdohet me këtë agjendë edhe më tej? Do të duhej të procedohej Projekt-kodi i procedurës penale në Kuvend si dhe do të duhej të verifikohet pasuria e zyrtarëve të lartë dhe kërkoi që të bëhet rishikimi i deklarimit të pasurisë nga zyrtarët publikë.

Dimal Basha, pyeti për sistemin e menaxhimit të lëndëve në gjykata, caktimin e rastësishëm të lëndëve, cilat janë problemet, me të cilat jeni ballafaquar për shkak të pandemisë Covid-19, si bëhet vlerësimi i performancës tek gjyqtarët, ku mori përgjigje nga përfaqësuesit e KGJK-së.

Selim Selimi, tha se sa i përket punëve të mbetura nga Qeveritë e kaluara do të vazhdojnë edhe më tej përmes agjendave të planifikuara.

Pas diskutimeve nga të pranishmit dhe anëtarët e komisionit, në lidhje me rekomandimet e Raportit të progresit, u kërkua që të ketë një plan të veprimit të secilit institucion, me qëllimin e vetëm për ti adresuar rekomandimet nga Raporti i progresit. Po ashtu, si Komision do të organizohen takime të përbashkëta në baza dy apo tremujore për të përcjellë progresin që ka bërë institucioni juaj për zbatimin e këtyre masave të cilat janë shumë të rëndësishme për integrimin evropian.

2. **Shqyrtimi i kërkesave buxhetore të institucioneve/agjencive të cilat bien në fushëveprim të Komisionit**

Kryetari, paraqiti për shqyrtim kërkesat buxhetore të institucioneve/ agjencive të cilat bien në fushëveprim të Komisionit dhe tha se është bërë një analizë nga Drejtoria për Hulumtime për Projektligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2021, pjesën organizative që mbikëqyren nga Komisioni për Legjislacion dhe kërkoi nga përfaqësuesit e institucioneve t'i adresojnë kërkesat e tyre buxhetore.

Shkëlzen Maliqi, tha se ka zbritje të buxhetit, 168 pozita janë më pak se në vitin 2020, se në vitin 2019 të lejueshme me buxhet. Për vitin 2021 janë të lejuara 65 pozita. Ka kërkesë buxhetore për Departamentin Special për trajtim jo të barabartë për paga, i cili është themeluar me Ligjin për Gjykatat. Po ashtu, kanë kërkesë për 10 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit, së bashku me staf profesional. Gjithashtu kanë kërkesë buxhetore nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme. Sistemi i SMIL-it po ashtu kërkon mirëmbajtje.

Lavdim Krasniqi, tha se nuk janë marrë parasysh kërkesat e KPK-së edhe pas dëgjimeve buxhetore, madje ka pasur edhe më shumë shkurtime buxhetore. Ka shkurtime të buxhetit edhe pse janë lidhur kontratat. Po ashtu, tha se aprovohet një numër i lartë i pozitave, por nuk aprovohet buxheti për këto pozita. Pra, buxheti është aprovuar më shumë tek kategoria ekonomike e shpenzimeve komunale dhe tek kategoria ekonomike e shpenzimeve kapitale, por jo e edhe tek kategoritë për mallra dhe shërbime dhe paga dhe mëditje.

Shaip Havolli, tha se janë hequr 4 pozita në vitin 2020 dhe kërkesa e tyre është të rikthehen 4 pozita sepse e kanë të pamundur të kryejnë punën. Po ashtu, tha se nëse miratohen dy ligjet, kërkohet rekrutim të stafit shtesë.

Valdete Daka, tha se gjendja është alarmante në lidhje me buxhetin sepse ato janë organizator të zgjedhjeve dhe për më tepër, që është vit zgjedhor sepse do të mbahen zgjedhjet lokale. Po ashtu i kanë dy pozita më pak dhe shpenzimet kapitale janë shkurtuar plotësisht ku në mesin e tyre është softueri i cili përdoret për tabulimin e rezultateve.

Anita Kalanderi, tha se për herë parë kanë rritje të buxhetit dhe të stafit. Kërkesa e tyre ka qenë për sigurimin e qëndrueshmërisë të 14 zyrave mobile. Po ashtu, tha se kanë kërkesë për të mbuluar edhe 17 komuna.

Shkëlzen Bajraktari, tha se shqetësim mbetet zvogëlimi i stafit të punëtorëve në këtë Agjenci nga 242 sa ka qenë e paraparë, në 200, me arsyetimin nga ana e Qeverisë se ende nuk është miratuar projektligji për këtë Agjenci tash e tre vjet. Po ashtu, kërkesë tjetër e kësaj Agjencie ishte nivelimi i pagave të punëtorëve në këtë Agjenci.

Enver Zejnullahu, tha se kanë 33 pozita të lejuara dhe kanë bërë kërkesë buxhetore për 11 pozita të tjera kyçe, pa të cilën ky institucion nuk mund të funksionojë.

Selim Selimi, tha se katër kërkesa buxhetore, ku e para është operacionalizimi i Gjykatës Komerciale për vitin 2021, 500 mijë € shtesë. E dyta t'iu jepet nga një pagë jubilare punonjësve të shërbimit korrektues për punën e mirë gjatë periudhës së Pandemisë Covid-19. Po ashtu, edhe për Avokaturën Shtetërore për një pagë më të dinjitetshme, pothuajse me prokuroritë dhe gjykatat sepse edhe ata e mbrojnë shtetit në rast të padive të ndryshme. E katërta, funksionalizimi i Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Pas paraqitjes së kërkesave buxhetore, anëtarët e komisionit u pajtuan që Agjencitë/Institucionet, brenda afatit prej tre ditësh ti dërgojnë me shkrim me arsyetimin e saktë. Komisioni do të formojë grupim e punës për t'i vlerësuar kërkesat buxhetore, të cilat do ti shqyrtojë pasi ti ketë në formë të shkruar dhe më pas do të përgatisë amendamentet me shkrim për t'i paraqitur në Komisionin për Buxhet dhe Transfere.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40.
E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Shkëmb Manaj,
Kryetari i komisionit

_____